



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIKA OF  
KOSOVA

AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIA ZA BORBU PROTIV KORUPCIJE NA KOSOVU  
KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY



## KONKURS

**Titulli i postit:** Zyrtarë i Lartë për Përkthime Shqip- Serbisht  
**Organizata:** Agjensioni Kosovar Kundërkorrupsionit- Departamenti për Shërbime Administrative  
Divizioni për Burime Njerëzore dhe Përkthime  
**Shifra e postit:** DSHA- 4.07  
**Koeficienti i postit:** 7  
**Paga:** 228 €

### Detyrat dhe përgjegjësit:

Zyrtari i Lartë për Përkthime Shqip-Serbisht nën mbikëqyrjen e Shefit të Departamentit për Shërbime Administrative dhe nën udhëheqjen e Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore dhe Shërbime Përkthimi ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

- Bënë përkthimin e shkresave të nevojshme për nevojat e Agjencionit të cilat kërkohen të përkthehen nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;
- Bën përkthime simulantë nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;
- Kryen edhe punë të tjera të natyrës së përkthimeve me kërkesën e Drejtorit të Departamenti i Administratës dhe Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore dhe Përkthimeve.

### Kualifikimet e nevojshme:

- Kandidati duhet të ketë përgatitje universitare
- Një (1) vite përvojë pune në profesion.
- Kërkohet njohuri e shkëlqyer e gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- Ai ose ajo duhet të ketë njohuri të mira në lidhje me legjislacionin në fuqi,
- Ai ose ajo duhet të jetë në gjendje të punojë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti,
- Ai ose ajo duhet të jetë i gatshëm ose e gatshme të punojë jashtë orarit nëse është e nevojshme,
- Të jetë banor i përhershëm i Kosovës,
- Posedimi i patentë shoferit është i dëshirueshëm,
- Njohja e punës me kompjuter Word-i, Excell-i, interneti, përpunimi i tekstit dhe përgatitja e raporteve buxhetore e prezantimeve janë të domosdoshme.

## INFORMATAT E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Kohëzgjatja e kontratës për të gjitha postet është 3 vjet me periudhë provuese tremujore dhe me mundësi vazhdimi. Agjensioni Kosovar i Kundërkorrupsionit ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë dhe të femrave.

Politika e punësimit të drejtë të gjitha komuniteteve të Kosovës, do të zbatohet në strukturën e stafit të Agjencionit. Kandidatët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen një testimi me shkrim, në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët tregojnë rezultatet në testim me shkrim.

## PROCEDURA E KONKURIMIT

Formulari për konkurrim mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Agjencionit Kosovarë Kundërkorrupsionit në Prishtinë (ruga "Bajram Kelmendi" nr. 31). Formulari zyrtar i konkurimit duhet të dorëzohet së bashku me letër motivimin dëshminë për kualifikimin shkollor, specializimin, kurset e ndjekura, përvoja e punës dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe të pakompletuara me të dhënat e kërkuara, si dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, do të konsiderohet i pavlefshëm.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikuar në shtypin ditor.**

**Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim nuk do të merren parasysh ndërsa kërkesat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.**

**Mirëpresim aplikimet e femrave dhe meshkujve nga të gjitha komunitetet e Kosovës.**

Kërkesa mund të dozohet në recepcionin e ndërtesës së Agjencionit Kosovare Kundërkorrupsionit në Prishtinë (ruga "Bajram Kelmendi" nr. 31) ose me postë, si dhe në Zyrën e Personelit nr .09 kati i dytë. Për informata shtesë mundë të telefononi në telefonin: 038 248 563 lok 118.